

NJË HAPË MË PËRPARA NË INFORMIM TË QYTETAREVE

Organizata Joqeveritare Youth Association for Human Rights me qëllimi të përmbushjes së qëllimeve dhe objektivave të saja në interes të qytetareve, ka filluar që nga muaji Dhjetor 2011 të nxjerrë numrin e parë të buletinit informativë, i cili do të jetë një dritare nëpër të cilën do të informohen qytetaret e Komunës së Lipjanit mbi të gjitha aktivitetet e Organizatës në interes të tyre.



FTESE

Redaksia e këtij buletini informativë fton të gjithë të interesuarit që dëshirojnë që të kontribuojnë me shkrime, analiza dhe hulumtime me qëllim të demokratizimit të shoqërisë dhe në mbrojtje dhe të përfaqësimit të interesave të qytetareve të Komunës së Lipjanit. Ti dërgojnë shkrimet në e-mailat e organizatës sonë dhe do të botohen në numrat tjerë të këtij buletini informativë.

Po ashtu redaksia e këtij buletini informativë kërkon falje për gabimet eventuale të paraqitura në këtë numër për shkak të shpejtësisë së përgatitjes dhe shpresojmë se në numrat e ardhshëm nuk do të paraqiten gabime të tilla.

YAHR-I NDAN ÇMIME PËR KONTRIBUES NË ARTIKULIMIN E PROBLEMEVE TË QYETAREVE PËR VITIN 2011

Të enjten me 1 Dhjetor 2011.

Organizata joqeveritare Youth Association for Human Rights me qëllim të ngritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve lokale komunale dhe të artikulimit të problemeve dhe interesave të qytetareve të Komunës së Lipjanit. Për vitin 2011 ka ndarë çmime apo mirënjohje për personat juridik dhe fizik të veçanta të cilët ka kontribuar që kjo çështje të ecë përpara.

Kjo traditë ka filluar që nga viti I kaluar dhe do të vazhdojë edhe në vitet në vazhdim.

Organizata Joqeveritare YAHR për këtë vit 2011 ka ndarë çmime/mirënjohje për:

Gazetën e përditshme Koha Ditore e cila ka qenë më aktive me mbulimin me informacione në qëllim të artikulimit të problemeve dhe interesave të qytetarëve të komunës së Lipjanit,

Në mungesë të media elektronike lokale që është një hendikep për qytetarët e Komunës së Lipjanit, por në zbutjen e kësaj mungese mediave lokale kanë kontribuar edhe mediat lokale të komunave fqinje dhe YAHR jep një çmim/mirënjohje:

Televizioni Tema me seli në Ferizaj për mbulimin me informacion nga Komuna e Lipjanit gjatë vitit 2011 .



ORGANIZOHEN PËR HERË TË PARË ZGJEDHJET PËR KËSHILLAT E FSHATRAVE NË KOMUNËN E LIPJANIT



VOTIMET PËRCAKTUAN 37 KRERË FSHATRASH PA PËRFAQËSIM FEMRE

Në zgjedhjet për udhëheqësi të fshatrave dhe lagjeve urbane të datës 10.07.2011 pjesëmarrës ishin 13 subjekte politike dhe 14 kandidat të pavarur. Votuan 4630 votues me të drejtë vote dhe zgjodhën 36 kryetar të fshatrave dhe lagjeve urbane me 245 anëtar të kryesive. Organizata Joqeveritare YAHR, në vazhdimësi është duke i monitoruar aktivitetet e Komitetit për çështje qytetare në organizimin e procesit zgjedhor për formimin e këshillave dhe të kryetarëve të 62 fshatrave të komunës së Lipjanit. Gjatë ditës së diele me 10.07.2011 ka monitoruar procesit të ditës së diele mbajtjes së zgjedhjeve për kryesitë dhe kryetarët e 39 fshatrave të komunës së Lipjanit. Ne kemi monitoruar procesin nga ora 07.00 deri në ora 23.30 minuta të ditës së diele 10/07.2011. Në vazhdim organizata Joqeveritare YAHR konstaton gjatë monitorimit: Procesi i zgjedhjeve nëpër 37 fshatra (Aklap, Babush i Muhaxherëve, Blinajë, Bujan, Dobrajë e Madhe, Dobrajë e Vogël, Gadim e Epërme, Gadime e Ultë, Gllanicë, Gllavicë, Glllogovc, Grackë e Vogël, Janjevë, Kleçkë, Konjuh, Kroishtë, Krojmir, Lagja Mostina Lipjan, Llugë, Llugaxhi, Magure, Marevc, Mirenë, Poturoc, Ribar i Madh, Ribar i Vogël, Qylagë, Shalë, Sillovi, Smallushë, Teqe, Topliqan, Zllakuqan) kryesisht ka shkuar mirë, ndërsa një vendvotim në fshatin Ruvç i vjetër është anuluar nga komitetit për çështje qytetare për shkak të parregullsive dhe në një vendvotimi nuk është hapur. Ndërsa në vendbanimet si Gadime epërme, Janjeve, Glllogovc etj. Procesi zgjedhor ka shkuar me një atmosferë zgjedhor të një standardi të lartë me fushat parazgjedhor të kandidateve të ndryshëm. Organizata jonë gjatë monitorimit ka vërejtur disa parregullsi, e sidomos në fshatin Poturovc ku një person ka votuar disa herë me letërnjoftimet e familjareve të tyre. Kemi vërejtur që në disa fshatra ka pasur bojkot të disa subjekteve politike, por pjesëmarrja në tërësi si proces zgjedhor ka qenë e mirë nga subjektet politike: PDK, LDK, AKR, AAK, VV dhe nga subjektet e partive minoritare nga partitë e komuniteteve: turk, RAE, kroat etj. Është interesant të cekim se nuk kemi asnjë anëtarë të zgjedhur nga gjinia femërore në kryesitë e fshatrave. Ku në këtë proces nuk ka vlejtur rregulli i 30%. Që është dashur të jetë. Organizata jonë e përgëzon Komitetin për çështje të qytetare për efikasitetin në organizimin e këtyre zgjedhor dhe të partive politike për pjesëmarrje në shtyrjen e procesit përpara.

Në orët e vona është raportuar për një incident në fshatin Sillovi nga komision zgjedhor i këtij fshati.

YAHR-I DEL ME RAPORT MONITORUES PËR PUNËN E EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT



Youth Association for Human Rights (YAHR) publikon raportin e monitorimit "Qeverisja Lokale në Lipjan" bazuar në monitorimin e punës së Komunës së Lipjan gjatë periudhës Janar – Tetor 2011. Monitorimi është fokusuar në Asambleenë Komunale dhe Ekzekutivin e Komunës, dhe përfshinë fushat: transparenca dhe llogaridhënia, demokratizimi dhe qeverisja e mirë, zhvillimi urban e ekonomik, arsimi dhe shëndetësia.

Raporti gjithashtu përmban analiza kualitative të legjislacionit në fuqi dhe praktikave më të mira mbi vetëqeverisjen lokale të cilat përdoren në lidhje me të gjeturat dhe përgjegjësitë e Komunës. Nga të gjeturat e monitorimit.

YAHR vlerëson se qeverisja në Komunën e Lipjanit ka përparime, përkundër disa problemeve në fusha të caktuara. Nga rrethi i përgjegjësive të cilin e ka, Komuna e Lipjanit është duke treguar pak rezultate të ndonjë progres në atë nivel sa të ndryshojë në mënyrë të dukshme në të mirë të qytetareve të komunës së Lipjanit.

Në kuadër të transparencës dhe llogaridhënies, që paraqesin dy prej shtyllave kryesore të funksionimit të institucioneve publike, Komuna e Lipjanit mbetet përgjithësisht e hapur për qytetarë dhe OJQ-të. Por, ka të meta të pajustificueshëm të mos informimit të qytetarëve për kohën e mbajtjes së mbledhjeve të komiteteve, e në veçanti të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) të Komunës së Lipjanit, një prej organeve më të rëndësishme.

Ekzekutivit të Komunës së Lipjanit nuk ka marrë me seriozitet vërejtjet dhe mangësitë të evidentuara nga Raportet e auditorit të pavarur për vitin 2008 dhe 2009 , të cilat janë përsëritura edhe nga Raportet e auditorit të pavarur për vitin 2010.

Në bazë të këtyre raporteve:

- Komuna e Lipjanit nuk mirëmban ndonjë regjistër të përgjithshëm të ndërtesave, makinerisë dhe pajisjeve. Për më tepër, regjistri i ndërtesave, makinerisë dhe pajisjeve nuk është harmonizuar me regjistrat kontabël të Komunës.,

- Komuna nuk ka listë të detajuar gjithëpërfshirëse të pronës, e cila përfshinë dokumentacionin e pronësisë e pronës së tillë dhe informacionin mbi statusin e regjistrimit në emrin e Komunës në Kadastër apo në Gjykatë. Për më tepër, Komuna nuk ka kryer verifikim dhe vlerësim fizik të të gjitha aseteve për 31 Dhjetor 2010.

Po ashtu ka vërejtje në:

- Komuna nuk ka implementuar një program të integruar kompjuterik kontabiliteti të brendshëm që do të siguronte informacionin për qëllime raportimi në kohë, të plotë dhe të saktë.

- Komuna nuk ka implementuar sistem gjithëpërfshirës dhe automatik të faturimit dhe nuk mirëmban libra të veçantë apo listë të gjithë debitorëve në lidhje me tatime të ndryshme. Në vend të saj vetëm mbledhjet në para të gatshme janë të regjistruara. Megjithëse llogaritë e arkëtueshme kërkohen të shpalojnë në pasqyrat financiare, mungesa e sigurisë dhe plotësisë do të ndikojë në të hyrat që Komuna mund të fitojë dhe aftësinë të përgatis buxhet të besueshëm dhe të sigurt, të raportojë shkallën e saktë të mbledhjes, dhe monitoroj mbledhjen e të hyrave vetanake në baza kohore.

- Kemi pa-pajtuueshmëri me ligjin Nr. 02/L-99 i nxjerrë me rregulloren Nr. 2007/20 që ishte nxjerrë nga rregullorja e prokurimit Nr. 2003/17 "Ligji i prokurimit publik në Kosovë (i ndryshuar). Kjo pa-pajtuueshmëri lidhet me kërkesat e procedurave të prokurimit të cilat nuk ishin kryer dhe dokumentuar nga Komuna. Raportin e plotë mundeni ta shkarkoni nëpërmes uebfaqes:

http://yahr-monitorimi.weebly.com/uploads/8/3/6/8/8368453/yahr_raport_mbi_punen_e_ekzekutivit_ne_komunen_e_lipjanit_4_2011.pdf